



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 1034/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Sakip Makasqi kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë nga subjekti politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), dega në Prizren paraqitur kundër Komisionit Qëndror Zgjedhor (KQZ), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunalë seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Sakip Makasqi kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë në Prizren nga subjekti politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP).

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Sakip Makasqi kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë nga KDTP në Prizren në të cilën pretendon se nuk është numëruar apo është bërë gabim me numërin, si dhe insiston që të marrë pjesë në rinumërimin e votave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 1034/2013 më datën 06.12.2013



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24( njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.